

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e konsultimit publike ishte 20 ditë pune, duke filluar nga data 4 mars 2024 deri më 29 mars 2024.

3. Metoda e konsultimit

1. Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
2. Posta Elektronike Zyrtare
3. Konsultime të Grupit të Punës

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara që kanë dhënë komente në konsultimet publike:

1. Organizata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” (ODPSHL)
2. Dhoma e Biznesit të Diasporës (DHBD)
3. Këshilli Kombëtar i Diasporës (KKD)
4. Qendra e Botimeve të Diasporës (QBD)
5. Esmeralda Arifi
6. Anila Hyka Smorgrav
7. Etmond Guri - Anëtar i Bordit Drejtues të Diasporës Shqiptare në Greqi; Ish-kryetar i Federatës së Shoqatave Shqiptare në Greqi; Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Kulturore dhe Artistike “Lushnja” në Greqi; Përgjegjës i Departamentit të Drejtave të Njeriut dhe Integritetit pranë Organizatës “JETA”; Aktivist me pjesëmarrje në shumë institucione në Greqi, siç anëtar në Këshillin e Kontrollit Social në Radiotelevizionin Kombëtar të Greqisë – ERT; Anëtar i Këshillit të Integritetit të Emigrantëve në Bashkinë e Athinës nga viti 2015 – 2023, etj.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit:

1. Zëvendësministri që mbulon çështjet e diasporës, Kryetar;
2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Politike dhe Strategjike, anëtar;
3. Drejtori i Drejtorisë së Rajonit dhe Vendeve Fqinje, anëtar;
4. Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, anëtar;
5. Drejtori/Përgjegjësi i Sektorit i Drejtorisë së të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve, anëtar;
6. Drejtori/Përgjegjësi i Sektorit i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, anëtar;
7. Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, anëtar;
8. Drejtori i Qendrës së Studimeve Arbëreshe, anëtar;
9. Specialisti i Drejtorisë së të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve, sekretar.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht)	Justifikimi
---	--	--	--	-------------

<i>e..., rregullimi i..., etj.)</i>		<i>çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	<i>/l refuzuar)</i>	
Shtimi i termit “entitet” në Objekti i projektligjit (neni 1) dhe Organet përgjegjëse për diasporën (neni 3, pika 10)	- Të shtohet termi “entitete publike” për arsye se termi ligjor i identifikimit është entitet.	DHBD	Pranuar pjesërisht	- E drejta e brendshme njeh termin “ent publik”. Enti publik është çdo subjekt i së drejtës publike jo shtetëror, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik. (Përkufizimi i dhënë në ligjin nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”). Entet janë subjekte autonome (politikisht, administrativisht dhe financiarisht).
	- Ndryshimi i nenit 1 që të jetë më gjithëpërfshirës.	Anila Hyka Smorgrav	Pranuar	- Riformuluar neni që të jetë sa më gjithëpërfshirës.
Përkufizimet (neni 2)	- Përkufizimi i “Ministrit Përgjegjës”. Ne rastin kur përgjegjësia për Diasporën i ka kaluar MEPJ, ne ligj ne nene te ndryshme here përdoret “MEPJ “ here i behet referim “Ministri përgjegjës për Diasporën”. Kjo krijon konfuzion. Ndoshta duhet përcaktuar ne përkufizim një përcaktim me i plote. - “Vendi i Origjines eshte Republika e Shqiperise”. Si përcaktohet vendi i origjinës për pjestaret e diasporës. Mungon ne këtë rast përkufizimi i “pjesëtarit te diasporës shqiptare”. - Përkufizimi i Këshillit Koordinues i Diasporës duhet të jete me i plote për te kuptuar rolin e tij.	Anila Hyka Smorgrav	Pranuar pjesërisht Refuzuar Refuzuar	- Ligji referon ministrin përgjegjës për punët e jashtme, vetëm në nenin 19 (Përbërja e Këshillit), kjo për shmangur ndryshimet legjislative në rast ndryshimi të fushës së përgjegjësisë së institucioneve. - Ligji objekt konsultimi referon Diasporwn me origjinw shqiptare. - Do të hartohet akt nënligjor për të detajuar rolin e

				KKD, krahasd prashikimit në nenin e dedikuar në ligj për KKD-në.
Shtimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës tek Organet përgjegjëse për Diasporën (neni 3), si dhe shimi i një neni të ri dedikuar DHBD	- Shtohet entiteti publik: Dhoma e Biznesit të Diasporës - Shtohet nen i ri në vijim të QKD-së si vijon: DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS 1. Dhoma e Biznesit të Diasporës dhe këshillat sektorial e ndërsektorial udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga parimet e ligjshmërisë, transparencës, lirisë së organizimit, vetë rregullimit, mbrojtjes së lirive dhe të drejtave ekonomike të subjekteve tregtare, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, si dhe të bashkëpunimit me organet e administratës publike dhe përfaqësitë diplomatike. 2. Dhoma e Biznesit të Diasporës ngrihet dhe funksionon në bazë të këtij ligji, si person juridik publik dhe nuk ushtron veprimtari fitimprurëse. Ajo ka stemën dhe vulën e saj. 3. Aktiviteti ekonomiko-financiar i Dhomës së Biznesit të Diasporës, mbikëqyret nga Ministri përgjegjës për Diasporën. Dhoma e Biznesit të Diasporës, komunikon brenda muajit korrik të vitit pasardhës, pasqyrat financiare pranë Drejtorisë së Përgjithshme përgjegjëse për Diasporën. Ajo i komunikon Ministrisë përgjegjëse për Diasporën, Strategjinë afatshkurtër dhe afatmesme, planin e masave, si dhe listën e anëtarësisë dhe aktiviteteve vjetore dhe planifikimin e buxhetit brenda muajit dhjetor për vitin pasardhës të miratuara nga organet e vendimmarrjes së Dhomës. 4. Dhoma e Biznesit të Diasporës, krijon statutin e saj, dhe në përputhje me të, mund të krijojë degë apo përfaqësi brenda dhe jashtë vendit. 5. Dhoma e Biznesit të Diasporës përbëhet nga anëtarët e saj që janë subjektet tregtare dhe/ose persona fizik, që ushtrojnë veprimtari tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë vendit, të cilat zotërohen tërësisht apo pjesërisht nga shqiptarë të diasporës si dhe nga persona fizikë ose juridikë vendas ose të huaj, bashkëpunëtorë të tyre. 6. Dhoma e Biznesit të Diasporës ka për qëllim krijimin e një fryme bashkëpunimi ekonomik mbarë shqiptar nëpërmjet nxitjes së investimeve direkte dhe indirekte si dhe partneriteteve, nëpërmjet ofrimit të informacionit të specializuar dhe profesional për të nxitur dhe orientuar sipërmarrjet dhe kapitalin	DHBD	Refuzuar	- DHBD është shoqatë jo fitimprurëse, krijimi dhe funksionimi i së cilës legjitimohet dhe rregullohet me vendimin e gjykatës së rrethit Tiranë nr.6378, datë 12.11.2019, si dhe nga ligji nr.8788/2001.

	investues të Diasporës në Ekonominë e vendit, si dhe të bashkërendojë dhe bashkëveprojë me përfaqësitë diplomatike për mbrojtjen e të drejtave, nxitjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sipërmarrjes në diasporë atje ku ata veprojnë. 7. Burimet e të ardhurave të Dhomës, janë Projektet, sponsorizimet, kuotat e anëtarësisë, organizimi dhe tarifat e regjistrimit të cilat përcaktohen me vendim të Kryesisë, mbi parimin e anëtarësimit vullnetar. Dhoma mund të kryejë edhe fushata sponsorizimi për aktivitetet e saj apo për realizimin e qëllimit të saj. 8. Organet e Dhomës së Biznesit të Diasporës janë; Presidenti i Nderit, Kryetar, Nënkyetar, Koordinatorët e Shteteve të përfaqësimit, Drejtor Ekzekutiv dhe organe të tjera këshillimore apo organizative të cilat, së bashku me kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shpërblimet, përcaktohen në statutin e Dhomës dhe mund të ndryshohen me vendim të asamblesë së Përgjithshme me parimin se në çdo organ të zgjedhur dhe këshillimor duhet të plotësohet kushti i anëtarësisë në masën mbi 50 % anëtarë nga diaspora - Shfuqizimi i fjalës shtetërore nga neni, bie ne kontradiktë me titullin e Kreut “Organet Shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me Diasporën” - Shfuqizimi i FSHZHD, bie ndesh me strategjinë kombëtare te qeverise lidhur me implikimin ekonomik të Diasporës ne zhvillimin e vendit, si dhe largon nje potencial te mire te bashkëpunimit ekonomik.	Anila Hyka Smorgrav	Pranuar Refuzuar	- Reflektuar në nenin 3 dhe 4 të projektligjit. - Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, që prej vitit 2022 ka pasur mungesë fondesh, gjë që ka shkaktuar mosfunksionimin <i>de facto</i> të tij që para kalimit në fushë përgjegjësie të MEPJ-së. Si pasojë, ka humbur qëllimin e krijimit të FSHZHD-së, për sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjinë kombëtare për diasporën, nëpërmjet
--	---	------------------------	--------------------------------	---

				promovimit, inkurajimit dhe nxitjes së prirjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të diasporës në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.
Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave (neni 4)	- Të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Këshilli i Ministrave nxit dhe stimulon lidhjen e marrëveshjeve me strukturat homologe në trevat shqipfolëse për bashkëveprim në fushën e arsimit, kulturës, ekonomisë, inovacionit dhe më gjerë”.	KKD	Refuzuar	Këshilli i Ministrave ka tagrin për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe është i panevojshëm parashikimi në këtë ligj, në kushtet kur procesi i lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohet me ligj të posaçëm, atë nr.43/2016.
Shfuqizimi i Komitetit Shtetëror për Diasporën (neni 4/1)	- Perse i hiqet Këshillit të Ministrave përcaktimi i politikave për Diasporën ? A nuk duhet të jete KM të përcaktojë dhe koordinojë të tilla politika si pjese e strategjisë kombëtare?	Anila Hyka Smorgrav	Refuzuar	Komiteti Shtetëror për Diasporën, i cili ekzistonte në kohën e një Ministri Shteti për Diasporën (ministri pa portofol) dhe ku vendimet për çështje të ndryshme të diasporës merreshin nga ky komitet në të cilin përfshiheshin disa institucione shfuqizohet pasi në realitetin aktual, kur çështjet e diasporës i kanë kaluar një institucioni si MEPJ, në varësi të të cilës është edhe AKD, vendimet nuk mund të merren nga institucione të tjera, por nga ministria

				përgjegjëse për çështjet e diasporës.
Rritja e numrit të përfaqësuesve të diasporës në KKD (neni 19, pika 1)	- Rritja e numrit të përfaqësuesve të diasporës në KKD nga 15 në të paktën 21 përfaqësues. - Përgjigja është pozitive, por nevojitet të rishikohen modalitetet e përzgjedhjes së anëtarëve dhe numri të jetë i përcaktuar bazuar në numrat dhe nevojat e komuniteteve që këta anëtarë duhet të përfaqësojnë. - <i>“Sa për komunitetin e Greqisë, kemi dërguar peticion i cili ende nuk ka marrë asnjë përgjigje dhe të jepet llogari për "emerimet" që bëri ambasadorja shqiptare në Greqi Luella Hajdaraga duke përcare kështu komunitetin shqiptar Greqi dhe duke shkelur kushtetuten.”</i> - Komente për mënyrën e përzgjedhjes së përfaqësuesve të diasporës të paktën të atyre që përfaqësojnë Greqinë, me emërime dhe jo me zgjedhje, në mënyrë jo transparente dhe abuzive.	KKD ODSHPL Anila Hyka Smorgrav Esmeralda Arifi Esmeralda Arifi Etmond Guri	Pranuar Refuzuar	- Modalitet përcaktohen me akte nënligjore që nuk janë objekt i konsultimit. Objekt konsultimi është ligji nr.16/2018. - Modalitet përcaktohen me akte nënligjore që nuk janë objekt i konsultimit. Objekt konsultimi është ligji nr.16/2018. - Objekt i këtij konsultimi është projektligji për Diasporën, jo aktet nënligjore në zbatim të tij, që do të rregullojnë modalitetet e përzgjedhjes së anëtarëve të KKD-së.
KKD dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të KKD (neni 20)	- Shihet si domosdoshmëri krijimi i një këshilli diasporë, i zgjedhur nga organizatat e diasporës që mund të kontribuojnë në vijimësi për përcaktimin e linjave të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, dhe jo nga organet shtetërore. - Nëse një këshill do të përbëhej nga individë të shquar dhe me influencë në diasporat përkatëse, do të shërbente si urë për marrëdhëniet me diasporën, promovimin e Shqipërisë me qëllim ndikimin pozitiv në ekonominë e vendit.	ODSHPL KKD	Refuzuar	- Një organizatë përfaqëson vetëm vullnetin e anëtarëve të saj dhe se duhet parë nëse këto organizata njihen ose jo, çfarë përfaqësojnë a janë gjithëpërfshirëse, sipas ligjeve përkatëse të çdo shteti. Përbërja e Këshillit mund të rregullohet me Rregulloren e KKD, për të mos ngarkuar më tej ligjin.

	- Komente në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të KKD dhe zbatueshmërinë e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 340, datë 06.06.2018. - Shtimi i dy funksioneve të KKD, me përmbajtje si më poshtë: d) Propozon dhe miraton programacionin e kanalit të dedikuar nga Radio Televizioni Shqiptar për diasporën; e) Miraton përdorimin e fondeve për zhvillimin e marrëdhënieve me diasporën.	ODSHPL		Krijimi i Këshillit, në vetvete fillon me kandidaturat e propozuara nga organizatat e diasporës, që nënkupton se këto organizata janë pjesë e rëndësishme e këtij procesi.
		KKD	Refuzuar	- Objekt i këtij konsultimi është projektligji për Diasporën, jo aktet nënligjore në zbatim të tij. - Programacionet e RTSH-së miratohen nga Këshilli Drejtues i RTSH-së si edhe KKD është një organ përfaqësues, koordinues dhe këshillimor i marrëdhënieve me diasporën dhe jo vendimmarrës, aq më tepër për fondet.
Moskufizimi gjeografik i anëtarëve të KKD (neni 20)	- Në përbërjen e Këshillit ka vende të përcaktuara specifiku dhe ky nen duhet të përfshijë vende të tjera ku ka diasporë, në numër më pak të konsiderueshëm, si Kina, Afrika, ndaj ky nen duhet të jetë më gjithëpërfshirës. - Përgjigja është pozitive, por nevojitet përcaktimi i kriterëve lidhur me përbërjen e vendndodhjen e komuniteteve si dhe në bazë të kategorive të formimit profesional. - Shfuqizimi i kësaj pikës 4 “vendi i origjinës nuk ushtron influence ne procedurat dhe kushtet e përzgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit” - heq mundësinë përfaqësimit në Këshilla përfaqësues të trevave shqiptare si Mali Zi , Kosova dhe Maqedonia (si vende të origjinës). Në ligjin aktual Këshilli Koordinues kishte përfaqësues nga të gjitha trevat shqiptare pa	IOM ODSHPL Anila Hyka Smorgrav Anila Hyka Smorgrav	Pranuar pjesërisht Refuzuar Refuzuar	- Riformuluar që të jetë sa më gjithëpërfshirës, pa përmendur shtetet nominalisht. - Rregullat e hollësishme, përcaktohen me akte nënligjore, jo në ligj. - Procedura dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të KKD-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Mbulimi gjeografik

	dallim dhe çfuqizimi i kësaj pike, kufizon për zgjedhjen në baze të vendit të origjinës, që në neni 2 “përkufizime lidhet vetëm me Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu duke mos pasur në ligj përkufizimin e Vendi të orgjines, ky nen i ndryshuar lejon hapësirë për abuzime me konsekuenca të përçarjes kombëtare në Diasporë.			është lënë i hapur për të pasur sa më shumë përfaqësim dhe gjithëpërfshirje nga Diaspora në KKD, duke u mos kufizuar vetëm në vendet ku ka një numër të madh shqiptarësh.
KKD (neni 18)	- Ndryshimi i fjalës “përcakton linja orientuese për strategjinë e diasporës” në “sugjeron linja orientues për strategjinë e diasporës”, minimizon kontributin e anëtarëve të KKD-së si një nga zërat kryesorë të problemeve dhe interesave të Diasporës në krijimin e strategjisë kombëtare. Fjala “Sugjerim” do të thotë që Ministria përgjegjëse për Diasporën ruan të gjitha të drejtat të mos i marrë parasysh sugjerimet. - Përse duhen kufizuar kompetencat e KKD, vetëm në këto pika, duke lënë jashtë “edukimin, shëndetësinë, tematikën sociale rininë, gruan, fëmijët”?	Anila Hyka Smorgrav	Refuzuar N/A	- Ndryshimet e bëra janë në aspektin gjuhësor dhe jo përmbajtësor, pasi është e qartë që politikat për çështjet e diasporës hartohen nga Këshilli i Ministrave. Roli që i jepet KKD-së në ligj tregon për rëndësinë që ka kjo strukturë në procesin e hartimit të politikave si kontribues. - Kompetencat e KKD në këtë kuadër nuk janë kufizuar përkundrazi janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të përfshijnë një spektër të gjerë fushëveprimi. Ushtrimi i tyre përfshin në vetvete edhe pikat sipërcituar në koment, nëpërmjet shtimit të gërmës (ç), pika 2 neni 18 i Ligjit, ku cilësohet shprehimisht se “Këshilli Koordinues i Diasporës identifikon, trajton dhe propozon

	- Ndryshimi i pikës 3, që “anëtarët e Këshillit mbajnë kontakte, organizojnë aktivitete me komunitetet shqiptare në shtetet që përfaqësojnë, në varësi të agjendave të planifikuara nga kryesia e Këshillit” nuk ka vend ne ligj, pasi është e lidhur me rregulloren e brendshme te Keshillit dhe është ne kontradiktë me rolin dhe mandatin e anëtarit te Keshillit is përfaqësues i komunitetit te vendit ku jeton. Gjithashtu “kryesia e Këshillit” nuk ka asnjë kuptim dhe përkufizim ne ligjin e diasporës.		Pranuar pjesërisht	çështje dhe projekte me natyrë ekonomike, ligjore, kulturore, shkencore e sportive për diasporën”. KKD përmes trajtimit të çështjeve të natyrës së ndryshme dhe propozimit të projekteve mund të prekë dhe tema me interes për diasporën të përshtatshme me nevojat apo aftësitë e tyre të tilla si: edukimi, shëndetësia, tematika sociale, rinia, gruan, fëmijët etj. - Hequr referimi tek “kryesia e Këshillit” Përcaktimi i pikës 3 të Nenit 18 të Ligjit, është në përputhje me ushtrimin <i>de jure</i> dhe <i>de facto</i> të kompetencave, si dhe me <i>modus operandi</i> të anëtarit të KKD, pasi nuk mund të konceptohet ushtrimi i rolit të anëtarit i veçuar nga komuniteti të cilin ai/ajo përfaqëson çka nënkupton mos kultivimin e lidhjeve dhe kontakteve me komunitetin shqiptar në shtetin pritës. Përcaktimi i pikës 3, paraqet një klauzolë dhe
--	---	--	---------------------------	--

				garanci ligjore, të asaj që do të detajohet në vijim me akt rregullator (<i>Rregullore e KKD</i>) dhe nuk vjen në asnjë rast në kundërshtim me mandatin e anëtarit të KKD.
Ndërmarrja e veprimeve të mëtejshme për gjuhën arbëreshe, si një nga gjuhët që duhet përkrahur për ruajtjen dhe lëvrimin e saj (neni 10)	- Të shtohet një pikë ku të përfshihet edhe gjuha arbëreshe. - Nevojitet pasja si reference e një studimi të mëparshëm mbi këtë zhvillim të gjuhës arbërore si pjesë e trungut të së njëjtës gjuhë me shqipen dhe konsultimi vazhdueshëm me gjuhëtarët akademikë apo edhe financimi i studimeve të lëmit të “gjuhëve arbëreshe” duke qenë se të tilla ka në disa vende (Itali, Greqi). - Rezerva është e lidhur me pyetjen sa janë konsultuar akademikët lidhur me “gjuhët arbëreshe” pasi nuk behet fjalë vetëm për një gjuhë arbëreshe.	QSPA ODSHPL Anila Hyka Smorgrav	Pranuar N/A	- Komentet vijuese janë të përgjithshme dhe nuk i shërbejnë përmirësimit të projektligjit, megjithatë, sqarojmë se Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, si i vetmi institucion publik në Shqipëri që merret ekskluzivisht me universin arbëresh, që në themelimin e saj në vitin 2020, ka hartuar strategjinë e shtetit shqiptar në lidhje me problemet prioritare për arbëreshët. Në këtë kuadër, çështja e gjuhës arbëreshe si “gjuhë në rrezik” e shpallur nga UNESCO që në vitet ’90, ka qenë në fokus të studimeve nga ana e këtij institucioni duke u ngritur për herë të parë ky shqetësim në nivel akademik, por edhe politik në kuadër të mbështetjes që

	- Dakord, madje duhet zgjeruar edhe në vende të tjera më specifike, siç është Greqia. I gjithë faktori i Diasporës duhet të angazhohet në këtë drejtim duke bashkëpunuar dhe koordinuar përpjekjet sëbashkë si me institucionet shtetërore po ashtu edhe me faktorin e diasporës si: shoqata, organizata, fenderata, shoqëria civile etj.	Etmond Guri		shtetit shqiptar i bën diasporë së vet historike, siç janë arbëreshët. Për këtë qëllim, nga ky institucion janë organizuar një seri kuvendesh studimore me studiues nga bota, albanolog shqiptar nga të gjitha trevat shqipfolëse por edhe aktivitete kulturore që synojnë rrjetëzimin e gjuhës arbëreshe përpos librave të botuara nga ana e Qendrës. Për më gjerë mund të konsultohet faqja zyrtare e kësaj qendre www.qspa.gov.al, ku do të gjeni të gjitha aktivitetet e zhvilluara në këto katër vite punë të institucionit, librat e botuar etj. - Formulimi aktual parashikon ndihmesën dhe zhvillimin në vendet ku ka një numër të madh pjesëtarësh të diasporës, apo interes të veçantë shtetëror.
Komente mbi përfaqësimin e diasporës, mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të saj	- Mungesa e reflektimit të të drejtës kushtetuese të votës.	ODSHPL Anila Hyka Smorgrav	Refuzuar	- E drejta e votës është e drejtë kushtetuese që garantohet nga Akti themelor i Republikës së Shqipërisë për të gjithë shtetasit shqiptarë. Procesi i ushtrimit të kësaj të drejte rregullohet nga

	- Mungesa e reflektimit të mënyrës së përzgjedhjes së anëtarëve të KKD. - Mungesa e reflektimit të mbulimit gjeografik të komuniteteve shqiptare në botë. - Dhe në bazë të kategorive të përfaqësimeve ekspertize profesionale.	ODSHPL ODSHPL Anila Hyka Smorgrav		legjislacioni në fuqi për procesin zgjedhor në Kuvendin e RSH. - Mënyra e përzgjedhjes është e reflektuar në nenin 20, pika 3 të ligjit, duke iu dhënë tagri Këshillit të Ministrave për përcaktimin e rregullave të hollësishme me VKM. Nga pikëpamja e teknikës legjislative, rregullat e hollësishme për trajtimin e një çështje, bëhen me akt nënligjor. - Mbulimi gjeografik është lënë i hapur për të pasur sa më shumë përfaqësim dhe gjithëpërfshirje nga Diaspora në KKD, duke u mos kufizuar vetëm në vendet ku ka një numër të madh shqiptarësh.
Komente të përgjithshme	- Mungesa e referencave të neneve dhe dispozitave të shmangies së mospërputhjeve të kuadrit rregullator dhe të pakuptueshmërisë së dispozitave të ligjit.	Anila Hyka Smorgrav	Refuzuar	- Shmangia e mospërputhjeve me kuadrin rregullator referon legjislacionin për shërbimin e jashtëm, siç përmendet dhe në relacion. Kjo për faktin se tashmë çështjet e Diasporës janë edhe <i>de jure</i> pjesë e shërbimit të jashtëm.

	- Argumentimi për përdorimin e vetëm një kanal komunikimi, ndërkohë që aktivitetet lidhur me Diasporën ndahen në përgjegjësinë e 2 ministrave: Ministria e Arsimit përmes Qendrës së Botimeve të Diasporës (gjithshka që lidhet me shkollat shqipe dhe ruajtja e gjuhës) si dhe MEPJ.			- I vetmi kanal komunikimi për çështjet e diasporës do të jetë MEPJ. Fakti që për disa aspekte fusha e përgjegjësisë ndahet me MAS-in nuk do të thotë që do të ndahet edhe kanali i komunikimit.
Qendrat Kulturore për Diasporën (neni 6, pika 4)	- Qendrat Kulturore për Diasporën duhet të përfaqësojnë komunitetin shqiptar dhe organizatat e diasporës në vendin ku ka veprimtarinë, si dhe duhet të jenë në koordinim të vazhdueshëm me kreun e misionit diplomatik në atë vend. Mënyra si propozohet në projektligj “QKD është në varësi të kreut të misionit diplomatik të akredituar në atë vend...” është kontradiktor, pasi nuk përfaqëson kontributet e donatorëve dhe afekton misionin diplomatik.	ODSHPL	Refuzuar	- Themelimi i Qendrës kulturore për diasporën, si strukturë në varësi të kreut të misionit diplomatik të akredituar, është kompetencë e ministrit përgjegjës për diasporën në marrëveshje me shtetin ku do të ushtrohet veprimtaria e saj në interes të diasporës shqiptare. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të saj miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërsa organizatat e ndryshme të diasporës janë organizime vullnetare, jofitimprurëse, të themeluara, organizuara, financuara në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e shteteve ku jeton diaspora. QKD ndryshon prej tyre për sa i përket formës së themelimit,

			organizimit, financimit por jo misionit i cili është një dhe i përbashkët, ai i ruajtjes dhe kultivimit të identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor, arsimor, promovimit të Shqipërisë dhe nxitjes e përmirësimit të nivelit të bashkëpunimit kulturor, sportiv, arsimor, shkencor, teknik, teknologjik, ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës në përputhje me politikat dhe strategjitë gjithëpërfshirëse dhe të integritit. Funksionimi i saj si një strukturë integrale e misionit diplomatik dëshmon vëmendjen dhe kujdesin e qeverisë shqiptare për mbrojtjen e interesave, të të drejtave dhe përkushtimin për forcimin e lidhjeve ndërmjet diasporës dhe institucioneve shqiptare duke synuar angazhimin e saj të çmuar në zhvillimin dhe prosperitetin e vendit. Dhe ky mision sigurisht nuk përmbushet pa organizatat e diasporës, roli dhe
--	--	--	---

	- Mandati ne ligj i kalon fushën e veprimtarisë përtej kulturës. Ne këtë rast duhet ndryshuar titulli i qendrës per te mirë prezantuar fushën e përgjegjësisë.	Anila Hyka Smorgrav	veprimtaria e të cilave është thelbësore në përmbushjen e misionit për krijimin e një hapësire të përbashkët mbarë shqiptare në zemër të familjes së kombeve europiane, në respekt të plotë me të drejtat e vendeve fqinje, sovranitetin e tyre dhe parimet e shëndosha ndërkombëtare. - Fusha e përgjegjësisë që rregullon ky nen nuk është prekur nga ndryshimet. E vetmja gjë që shtohen janë pika 5 dhe mënyra e krijimit dhe organizimit të Qendrave.
Përgjegjësitë e QKD-së (neni 7, pika 2)	- Kreu i QKD-së duhet të zbatojë një model të përcaktuar bazuar në nevojat e diasporës në nivel lokal si dhe në Strategjinë Kombëtare të Diasporës.	ODSHPL	- Strategjia Kombëtare e Diasporës përcakton në mënyrë të qartë strukturat publike dhe bashkëpunimin, bashkërendimin ndërmjet tyre. Kreu i QKD merr udhëzime nga Ministri përgjegjës i diasporës, i cili transmeton nëpërmjet tyre politikën dhe strategjinë e Qeverisë Shqiptare të cilat janë orientuar dhe orientohen vazhdimisht nga

	- Qendrat e Kulturës për Diasporën, të bëhen nëpërmjet bashkëpunimit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.	KKD	Refuzuar	një përqasje multidimensionale e nevojave jo vetëm aktuale por edhe ato potenciale (që mund të adresohen në vijim). Konsultimi me grupet e interesit në nivel lokal (pra në vendet pritëse) ka qenë dhe do të vijojë të jetë thelbësor në këtë proces. - Kjo çështje zgjidhet me konsultime dypalëshe me autoritetet përgjegjëse të Republikës së Kosovës dhe se nuk është e nevojshme përfshirja e këtij parashikimi në ligj. Për më tepër, ka marrëveshje dypalëshe me Kosovën, në këtë fushë, që janë pjesë e legjislacionit të brendshëm.
QKD (nenet 6-8)	- Nenet 6, 7 dhe 8 duhet të bashkohen duke qenë se i përkasin të njëjtës strukturë dhe ligji trajton më shumë se një strukturë. - Në pikën 2, neni 7, togfjalëshi "...ministri përgjegjës për diasporën...", zëvendësohet me togfjalëshin "ministri përgjegjës për punët e jashtme...". ne rastin konkret a nuk është Ministri përgjegjës për diasporën dhe Ministri përgjegjës për Punët e Jashtme. Dhe ne kushtet që ligji duhet ti shërbejë viteve të ardhshme, ku përgjegjësia për Diasporën mund ti kalojë një ministrie tjetër në të ardhmen, ky ndryshim nuk duhet pranohet. Kjo eviton nevojën për amende të reja në ligj.	DHBD Anila Hyka Smorgrav	Pranuar Pranuar	- Neni është riformuluar dhe projektligji nuk ka më referencë tek ministri përgjegjës për punët e jashtme. Ligji aktual e referon ministrin përgjegjës për punët e jashtme, vetëm në nenin 19 (Përbërja e

				Këshillit), pikërisht për të evituar ndryshimet legislative në rast ndryshimi të fushës së përgjegjësisë së institucioneve.
Lidhja e marrëveshjeve për përkrahjen e mësimi dhe avancimit të gjuhës shqipe (neni 10, pika 4)	- Lypet një marrëveshje ndërshtetërore për të përzgjedhur me konkurs mësues të diplomuar në gjuhën shqipe, me një minimum përvoje në Shqipëri (nga radhët e emigracionit sigurisht) dhe që marrin kreditë shtesë në Universitetet ku mësohet gjuha shqipe, në vendet ku jetojnë Shqiptarët. Të krijohet një komision “ad hoc” që do të menaxhojë këtë marrëveshje.	ODSHPL	Refuzuar	- Lidhja e marrëveshjeve ndërshtetërore varet nga vullneti dhe interesi i shteteve për të lidhur marrëveshje në këtë fushë. Procesi i lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare nga vendi ynë, rregullohet me ligjin nr.43/2016. Ndaj, dhe krijimi i komisioneve <i>ad hoc</i> që do të menaxhojë marrëveshjen ndërkombëtare parashikohet në vetë marrëveshjen.
(neni 10, pika 5)	- Tekstet e shkollave që përdoren në Shqipëri nuk janë të mjaftueshme, por metodika duhet të plotësohet nëpërmjet, mundësisht, “Të mësuarit nëpërmjet lojës”, pasi në disa prej rasteve fëmijët nuk dinë gjuhën Shqipe dhe e kanë kapërcyer moshën e të nxënës në mënyrë të pavullnetshme. Duhet të bëhen marrëveshje me shtetet ku ndodhen komunitetet Shqiptare në mënyrë që gjuha Shqipe të ofrohet si lëndë me zgjedhje në orarin mësimor.			- Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr.443, dt. 26.6.2019 “ Për organizimin e Procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”, përcakton shprehimisht në pikën 2 të tij që procesi mësimor dhe përzgjedhja e arsimtarëve në Diasporës mbështetet nga Ministria Përgjegjëse për Arsimin në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe

				shtetërore dhe në përputhje me legjislacionin e vendit pritës të Diasporës Shqiptare. Ky proces realizohet në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas fushës së përgjegjësisë. Gjithashtu me VKM nr.104, dt.28.02.2019 “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në Diasporë” përcakton krijimin e regjistrit të mësuesve. Gjithashtu për sa më sipër ekziston një marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim në fushën e Diasporës me objekt mësimin e gjuhës shqipe në Diasporë.
Informimi (neni 13, pika 1)	Kjo pikë nuk është gjithë përfshirëse dhe se në autoritetet e informimit, krahas RTSH, nevojitet të shtohet edhe Agjencia Kombëtare e Diasporës, si kanal informues.	KKD QBD	Refuzuar	AKD është institucion varësie i MEPJ dhe mbi bazën e të drejtës për informim Ministria ka strukturën e saj digjitale përmes së cilës informon çdo

				qytetar brenda dhe jashtë vendit.
Organizata e Diasporës (neni 17, pika 2)	- Ndryshimin e nenit 17 (Organizata e Diasporës) me këtë përmbajtje: Organizata e diasporës përfaqëson interesat e komunitetit Shqiptar në atë vend ku jeton dhe ka si qëllim promovimin e Shqipërisë dhe të përkrahë interesat kombëtare. Organizatat e diasporës janë të përbëra nga shtetas shqiptarë të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, zonës së Çamërisë, Arbëreshë, etj dhe referuar preambulës së Kushtetutës së Shqipërisë bashkimi i të gjithë komunitetit Shqiptar është aspirata e popullit Shqiptar ndër shekuj.	ODSHPL	Refuzuar	- Neni 2, pika 2 e ligjit nr. 16/2018 “Për Diasporën” i ndryshcmimuar, jep një përkufizim të qartë se çfarë përfshin termi diasporë. Në komentin e paraqitur nuk përfshihet paragrafi më poshtë i cili është në ligj. “komunitetet” e hershme shqiptare si dhe çdo person që gëzon origjinë shqiptare, i cili ka lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mban lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe ka dëshirë të ruajë lidhjet me Shqipërinë, të cilët ndonëse nuk kanë shtetësi shqiptare gëzojnë të drejtën në mënyrë të barabartë pa diskriminim për të qenë pjesë e organizatave të diasporës”, pra ligji parashikon një term më të gjerë dhe gjithëpërfshirës.
Zëvendësim emërtesash në nenin 19 të projektligjit, që shton nenin e ri 22 “AKD”	- Duke qenë se nuk kemi në sistemin shqiptar një emërtim Dhoma Kombëtare e Tregtisë, ajo mund të zëvendësohet me Dhoma e Biznesit të Diasporës dhe Dhomen Ekonomike Kombëtare, Dhoma Bilaterale Biznesi.	DHBD	Pranuar pjesërisht	Komenti nuk bën kuptimin në këtë nen, por në nenin 16 të projektligjit (që ndryshon nenin 19 të ligjit “Përbërja e Këshillit”). Emërtesa ligjore është Dhomat e

				Tregtisë dhe Industrisë parashikuar në ligjin nr.9640/2006, i ndryshuar, me të njëjtin titull. Dhoma Ekonomike Kombëtare (projekt në proces, dhe si i tillë nuk mund të përfshihet në projektligj), dhe Dhoma Bilaterale Biznesi nuk ekzistojnë të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi.
Marrëdhëniet me Kuvendin e RSH (neni 25 i projektligjit)	- Një anëtar i KKD të jetë anëtar këshillimor i nënkomisionit për diasporën. - Kërkohet që të përcaktohet një procedurë e posaçme për konsultime të ndryshme, për sa i përket tematikave për diasporën në nivel rajonal dhe atë mbarë-kombëtar, të komisionit të përhershëm për politikën e jashtme të Kuvendit të Shqipërisë me organizatat e diasporës dhe individë të spikatur e të përfshirë në politikat ekonomiko/sociale/administrative/ligjvënëse në vende të ndryshme në botë.	KKD ODSHPL	Refuzuar Refuzuar	- Janë komisionet parlamentare që kanë këtë funksion, në përputhje me legjisllacionin në fuqi për nënkomisionet e Kuvendit. - Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka një platformë konsultimi dhe për çështje të ndryshme të politikës, përpara miratimit të akteve në seancë parlamentare, kryen rregullisht konsultime me grupe të ndryshme interesi përfshirë, organizatat, shoqatat apo individë të spikatur për të shpalosur mendimet e tyre në funksion të transparencës dhe përmirësimit të punës institucionale. Për sa më sipër, Ministria për

				Evropën dhe Punët e Jashtme do referojë dhe një herë në takime të ndryshme që do të realizohen në të ardhmen pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse të të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara në konsultime.
Dita e Diasporës (neni 25)	- Dita Kombëtare e Diasporës, Samiti i Diasporës dhe Dita e Arbëreshëve të jenë në të njëjtën datë.	KKD	Refuzuar	Nuk mund të parashikohet me ligj mbajtja e aktiviteteve, pasi janë shumë logjistike dhe teknike për tu parashikuar në një akt të tillë.